



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, administruar në Bashkinë Shkodër me Nr.25214 Prot., datë 29.10.2024, ju sqarojmë se:

1. Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit)

Ju lutem gjeni më poshtë të dhënat e kërkuara.

në 000/mijë lekë												
	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023			Viti 2024 (Monitorimi I 8-Mujori)		
	Plani	Fakti	% e realizimit	Plani	Fakti	% e realizimit	Plani	Fakti	% e realizimit	Plani	Fakti	% e realizimit
Buxheti vjetor në total :	3,739,127	2,792,799	75%	3,997,883	2,950,183	74%	4,412,654	3,127,083	71%	4,808,757	1,836,664	38%
Nga ku për shërbimet sociale:	1,167,078	1,089,347	93%	1,194,124	1,138,446	95%	1,176,781	1,110,485	94%	1,065,473	636,641	60%
Programi 6190 : Strehimi	54,342	50,702	93%	6,878	6,862	100%	8,279	7,965	96%	71,022	2,617	4%
Programi 7220 : Shërbimet e kujdesit parësor	3,000	-	0%	5,850	2,850	49%	5,000	2,649	53%	4,000	-	0%
Programi 10140 : Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	684	-	0%	-	-	0%	-	-	0%	-	-	0%
Programi 10430 : Kujdesi social për familje dhe fëmijë	1,074,569	1,034,911	96%	1,154,814	1,110,571	96%	1,152,788	1,095,277	95%	969,937	629,470	65%
Programi 10661 : Strehimi social	34,483	3,734	11%	22,714	18,163	80%	6,020	2,293	38%	12,985	2,816	22%
Llogari jashtë thesari	-	-	0%	3,868	-	0%	4,694	2,301	49%	7,529	1,738	23%

2. A keni aplikuar në institucionet qendrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 “Njoftim për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror””, Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.

Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ është ofruar një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda procesit të de-institucionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institucionalizimit 2020-2022 të miratuar me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

“Strehëza” përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në “Strehëz”.

Sipas aplikimit, kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet me tre këste:

- Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 Lekë. që përkon në mënyrë përpjësimore me 7 muaj shërbim;
- Viti i dytë i zbatimit të projektit është financuar në masën 60% të vlerës së projektit;

- Viti i tretë i zbatimit të projektit është financuar në masën 30% dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim referuar udhëzuesit social për vitin 2022.

Në zbatim të shkresës me nr. 23964 prot, datë 28.12.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi fondet për programet e strehimit social për vitin 2023“, lidhja nr. 1, për të përfituar nga fondet për programet e strehimit të shpallura nga Ministria e Financave, me shkresën nr. 1420 prot., datë 31.01.2023, kemi aplikuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2023”. për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa sociale me qira (ish-konvikti i shkollës Veterinare), aplikim i cili është refuzuar.

Për vitin 2024, Bashkia Shkodër ka përzgjedhur aplikimin në thirrjen me programin “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi“ duke marrë parasysh impaktin e lartë që do të ketë investimi në këtë zonë. Rikualifikimi i zonave informale dhe integrimi i plotë me qytetin është një objektiv strategjik i bashkisë, që ndikon direkt me rritjen në aksesin e banorëve me shërbimet e bashkisë, rritjen e sigurisë dhe mbi të gjitha përmirësimin e cilësisë së jetesës në një zonë informale e cila do të transformohet dhe zhvillohet sipas standardeve më të mira.

Projekti i propozuar “Rikonstruksion i rrugëve Fermentim” parashikon rikonstruksionin e një sipërfaqeje prej rreth 10,500 m2 duke ndërhyrë në infrastrukturën nëntokësore dhe mbitoksore në një gjatësi lineare prej 3.5 km dhe impaktuar direkt përmirësimin e cilësisë së jetesës për mbi 1000 banorë.

Me shkresën nr. 8086/21 prot. datë 20.06.2024 ardhur nga ministria me lëndë “ Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2024”, administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr. 13350 prot., datë 24.06.2024, Bashkia Shkodër është shpallur fituese.

3. Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?

Për vitin 2024, Bashkia Shkodër ka përzgjedhur aplikimin në thirrjen me programin “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi“ duke marrë parasysh impaktin e lartë që do të ketë investimi në këtë zonë. Rikualifikimi i zonave informale dhe integrimi i plotë me qytetin është një objektiv strategjik i bashkisë, që ndikon direkt me rritjen në aksesin e banorëve me shërbimet e bashkisë, rritjen e sigurisë dhe mbi të gjitha përmirësimin e cilësisë së jetesës në një zonë informale e cila do të transformohet dhe zhvillohet sipas standardeve më të mira.

Projekti i propozuar “Rikonstruksion i rrugëve Fermentim” parashikon rikonstruksionin e një sipërfaqeje prej rreth 10,500 m2 duke ndërhyrë në infrastrukturën nëntokësore dhe mbitoksore në një gjatësi lineare prej 3.5 km dhe impaktuar direkt përmirësimin e cilësisë së jetesës për mbi 1000 banorë.

Me shkresën nr. 8086/21 prot. datë 20.06.2024 ardhur nga ministria me lëndë “ Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2024”, administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr. 13350 prot., datë 24.06.2024, Bashkia Shkodër është shpallur fituese.

Një pjesë e projektet propozimeve janë hartuar nga stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit, rinisë dhe shëndetit publik, një pjesë e të cilëve janë të trajnuar edhe për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve.

Njëkohësisht në Bashkinë Shkodër funksionon edhe një drejtori e posaçme për shkrimin e projekteve, Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, të cilët gjithashtu kanë shkruar një pjesë të projekt-propozimeve.

4. Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?

Në Bashkinë Shkodër trajtohen referuar muajit shtator:

- 2349 persona me pagesë paaftësie,
- 250 persona me pagesë para/tetraplegjie,
- 433 persona me pagesë verbërie,
- 2995 persona që trajtohen me shtesë kemp mbi pensionin e invaliditetit.

Në Bashkinë Shkodër trajtohen me ndihmë ekonomike :

- 1578 familje (sistemi i pikëzimit),
- 202 familje (fondi i kushtëzuar deri në 6%).

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”. Aktualisht janë në funksion 13 qendra; 8 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

5. Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj?

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të

procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM -së nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar, "VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Sa i përket numrit të aplikimeve për këto programe strehimi, për vitin 2024, kemi rreth 270 aplikime.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Benet Beci